



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE**

NR. 1290 Prot

Datë 09 / 02 / 2022

VENDIM

Nr. 13, dt. 09 / 02 / 2022

**PËR PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E BASHKISË PËR
AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), Ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, ligjin nr. 31/2015 dhe ligjin nr. 101/2020 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë "Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore më datë 06.03.2022", Vendimit nr. 2, datë 22.01.2022, "Për miratimn e disa afateve proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje që do të zhvillohen më datë 06 mars 2022",

VENDOSA:

1. Përcaktimin e vendit publik në territorin e Bashkisë Durrës për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore si më poshtë:

Bulevardi Dyrrah në krah të qendrës Kulturore Aleksandër Moisiu, tabela reklamuese me një sipërfaqe pre 42 m2.

2. Ngarkohet Policia Bashkiake që të mbikqyrë zbatimin e këtij vendimi në përputhje me nenin 79 pika 5 e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe bëhet publik.

KRYETAR

Emiriana Sako

